



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

Nr. 1096/16 Prot.

Durrës më, 21 .12. 2020

**VENDIM**

Nr. 12 , datë 03.12. 2020

**PËR**  
**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR,**  
**PUS-SHPIMI , FUSHË-MËZEZ , BASHKIA TIRANË, PËR SUBJEKTIN**  
**"GESTIAMO" SH.P.K PËR QËLLIME "SANITARE"**

Në mbështetje të shkronjës "b" të pikës 2, të nenit 12, pika 1, gërma "e" të nenit 41, pikës 2 të nenit 50 , të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar , V.K.M –së Nr. 696, datë 30.10.2019 "Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre" dhe të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore", me propozimin e Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm – Erzen – Mat , Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e rinovimit të lejes "Për përdorimin e një pus shpimi", subjektit "Gestiamo" sh.p.k për qëllime "sanitare".
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Ishëm – Erzen – Mat për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

SEKRETAR

Anastasi Meçi



KRYETAR

Roland Nasto

